



Tuma para gërmimit / Tumulus before the excavation

## TUMA E PISKOVËS

Tuma e Piskovës ka qenë pjesë e një varreze komplekse tumulare të shtrirë pranë brigjeve të Lumit Vjosë, mes qendrave të Këlcyrës dhe Përmetit. Gërmimet arkeologjike të kryera në fund të viteve 1970, zbuluan 116 varre. Tuma kishte lartësi 4.5 m dhe diameter 30 m.

Varri qendor i ishte një gropë e thjeshtë e rrethuar me dy unaza gurësh lumorë, dhe lidhej me fillimin e ndërtimit të tumës në Periudhën e Bronzit të Hershëm (2500-1900 p. Kr). Varrime të tjera kryhen mbi varrin qendor deri në Periudhën e Hekurit të Hershëm (1100-800 p. Kr), kur tuma përfundon dhe merr formën e një 'kodrine'. Varret ishin kryesisht të tipit 'cist' në trajtë arke me rrasa guri, por kishte dhe me gropë të thjeshtë. Mbizotëronte riti i varrimit me vendosje trupi dhe më rrallë ai me djegie. Varret e kësaj periudhe përmbanin më së shumti qeramikë me natyrë rituale, të prodhimit rajonal si edhe enë importi Mikenase.

Tuma ripërdoret në Antikitet (shek. 4-2 p. Kr) dhe njeh një fazë varrimesh intensive gjatë Mesjetës (shek. 7-13 m. Kr). Disa varrime janë kryer brenda varreve të mëparshme prehistorike, të tjera lidhen me varre të reja në trajtë arke. Varret mesjetare ishin individuale dhe familjare, madje të përdorura për dy ose tre gjenerata. Brenda tyre u gjet një numër i lartë stolish prej argjendi, bronzi dhe brum qelqi dhe më pak enë qeramike.



Varri qendor / The central grave

## THE TUMULUS OF PISKOVË

The tumulus of Piskovë was part of a large tumuli cemetery extended close to the river Vjosë banks, between the centers of Përmet and Këlcyrë. Archaeological excavations carried out in the late 1970's uncovered a total of 116 tombs. The tumulus was 4.5 high and had a diameter of 30 m.

The central tomb was a pit surrounded by two rings of pebbles stones and it represents the beginning of the construction of the tumulus in the Early Bronze Age (2500-1900 BC). Other graves were continuously set above the central tomb until the Early Iron Age (1100-800 BC), when the tumulus ended forming a visible 'burial mound'. The graves were mainly of cist type, lined with stone slabs, but simple pits were also found. Inhumation was the most common burial practice while cremation is only sporadically recorded. Grave goods of this period are mainly regional ceramics of possible ritual use, as well as imported Mycenaean products.

The tumulus was reused in Antiquity (4<sup>th</sup>-2<sup>nd</sup> c. BC) and has an intensive phase of occupation in Medieval period (7<sup>th</sup>-13<sup>th</sup> c. AD). Some of the burial used the previous prehistoric tombs, others were new cist graves. Medieval graves contained individual and multiple burials, sometimes consisting of two or three generations. They yielded a large number of silver, bronze and glass jewelry objects, and less ceramic vessels.



Varre Mesjetarë / Medieval graves